



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

**PROJEKTVENDIM
PËR SHQYRTIMIN ME PROCEDURË TË PËRSHPEJTUAR TË PROJEKTLIGJIT
“PËR RATIFIKIMIN E PROTOKOLLIT TË TRAKTATIT TË ATLANTIKUT
VERIOR PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT”**

Në mbështetje të neneve 78, pika 1, dhe 83, pika 2, të Kushtetutës, si dhe të neneve 28 dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

- I. Të shqyrtojë me procedurë të përshpejtuar projektligjin “Për ratifikimin e Protokollit të Traktatit të Atlantikut Verior për aderimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut”.
- II. Shqyrtimi në komisionin përgjegjës për Sigurinë Kombëtare të bëhet në datat 11-12 shkurt 2019.
- III. Komisione për dhënie mendimi caktohen komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut dhe komisioni për Politikën e Jashtme.
- IV. Shqyrtimi në seancë plenare të bëhet në datën 14 shkurt 2019.
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI